Çfarë duhet e nuk po ua mësojmë nxënësve tanë në shkolla?

Edona Begu

Në hovin e zhvillimeve shumë vende kanë vështirësi t'i ndërlidhin reformat arsimore për t'ju përshtatur ndryshimeve. Kosova është duke bërë përpjekje të reformojë arsimin në mënyrë që të arrijë zhvillimin e shkathtësive të nevojshme. Reformat e iniciuara në këto vitet e fundit në Kósovë kanë ardhur si shtytje e politikës qendrore të vendit. Politikëbërësit kanë rol kyç, pasi ata duhet të sigurohen të ndërtojnë ura lidhëse midis ritmeve të shpejta të ndryshimit të shoqërisë dhe asaj se çfarë ndodh në shkolla. Shteti i Kosovës ndër vite duke ndryshuar aktet ligjore dhe tentimeve të vazhdueshme për zhvillimin e kurrikulave ka synuar që të bëjë reforma por që nuk kanë rezultuar shumë efektive. Në këto vitet e fundit instrumenti kryesor që shteti i Kosovës ka përdorur për arritjen e reformave është prezantimi i një kurrikule të re. Kjo kurrikulë ndryshon qasjen e mësimdhënies duke e orientuar atë nga zhvillimi i kompetencave të caktuara te nxënësit dhe duke i dhënë autonomi më të madhe shkollave për përcaktimin e përmbajtjes dhe kohëzgjatjes së lëndëve. Në mungesë të përgatitjeve paraprake të mësimdhënësve/eve, kjo kurrikulë nuk si të mësojnë dhe si t'i ndërlidhin njohuritë e tyre me realitetin në të cilin jetojnë.

Është me rëndësi të theksohet se njohuritë ndryshojnë vazhdimisht dhe jogjithmonë gjërat duhet të merren nga vetëm nga një këndvështrim. Kjo na shpie te një tjetër problem, që lidhet me atë se çfarë u mësohet nxënësve në shkolla e që ka të bëjë me kurrikulën e bazuar në libër. Mësimdhënësit e Kosovës, janë të mësuar dhe ndihen më rehat në përdorimin e një librit si bazë dhe udhërrëfyes për lëndë. Kjo qasje teksto-centriste e mësimdhënies nuk ndihmon zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ te nxënësit. Pra, nxënësit duhet të udhëzohen të përdorin burime të ndryshme informimi, p.sh. internetin dhe libra të tjerë, që të marrin perspektiva të ndryshme për njësi të caktuara mësimore. Prandaj nxënësit duhet të krijojnë një mendim të tyrin kritik, duke u bazuar në të gjitha informatat e marra. Kështu që mësimdhënësit duhet të dinë t'u ofrojnë nxënësve mënyrën për gjetjen e informacioneve, duke i orientuar ata nga përdorimi i duhur i teknologjisë për hulumtim dhe mbledhje të informacioneve. Këtu, kujdes i theksuar duhet t'i kushtohet që nxënësit

Sallonet e së martës janë një nismë javore e institutit "Demokraci për Zhvillim" (D4D). Salloni ka format gjysmëformal, sipas rregullës "Chatham House" dhe pa prani të medieve. Diskutimi mbledh rreth vetes eksperte e analistë politikanë e publicistë për të reflektuar dhe për të kërkuar konsensus mbi temat e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në kanalin e salloneve në "YouTube". Secili Sallon përcillet me editorial që publikohet në "Zëri" të martën e arkivohet dhe në faqen elektronike të D4D-së. Podcastet bazuar në editorial mund t'i gjeni në ndërfaqen

është duke u zbatuar. Kjo prapë është edhe një rast kur ndryshimet nuk kanë sjellë rezultatet e dëshiruara.

Vështirësitë më të mëdha shkollat po i hasin në përcaktimin e temave dhe planifikimi për Kohëzgjatjen e lëndëve për secilën fushë të kurrikulës. Megjithatë, secili ndryshim fillimisht përcillet me rezistencë dhe problematika të vazhdueshme, por e rëndësishme në gjithë këtë ndryshim është që të mos humbet qëllimi kryesor i reformave dhe grupi i synuar - nxënësit. Prandaj, natyrshëm dhe vazhdimisht duhet të bëhet pyetja se "Çfarë u mësohet nxënësve në shkollat tona, e në fakt, do të duhej t'u mësohej?" Fatkeqësisht, shkollat e Kosovës janë të prira për të shtyrë nxënësit drejt mësimit të fakteve dhe mbajtjes mend të tyre që paraqet nivelin me të ulët të të mësuarit. Duket lënë anash aktivitetet më të larta kognitive si: të kuptuarit, aplikimin, analizën, vlerësimin dhe të krijuarit. Kjo është reflektuar edhe në rezultatet tejet të dobëta që Kosova pati në testin PISA, ku vetëm 25% e nxënësve të testuar arritën nivelin bazë në të lexuar, shkenca dhe matematikë. Fokusimi i tepruar në mbajtjen mend të fakteve është i gabuar sepse shpesh ndodh që faktet jo vetëm të jenë të vjetërsuara apo shkencërisht të gabueshme, por edhe u ndalojnë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike. Çfarë duhet t'u mësohet nxënësve, në fakt, është: se si të mësojnë. Albert Ajnshtajn thoshte se "edukimi nuk është mësimi i fakteve, por trajnimi i mendjes për të menduar". Dhe realisht, nxënësit tanë duhet të mësohen se

të dinë të vënë në pyetje atë që lexojnë dhe e mësojnë nga burimet e ndryshme të informacionit dhe të mos marrin si të mirëqenë çdo informacion. Një çështje tjetër e rëndësishme që lidhet me atë se çfarë u mësohet nxënësve në shkolla ka të bëjë me kurrikulën dhe me çka ajo përcakton si nevojat kryesore për nxënësit për të qenë të suksesshëm në tregun e punës. Kjo qasje ka anën pozitive, pasi sigurohet që të paktën të arrihet një minimum i të nxënit. Mirëpo, ajo është shumë rrafshuese dhe nuk merr parasysh faktorë të tjerë të rëndësishëm, si njohuritë paraprake të nxënësve që mund të lidhen me faktorë si prejardhja socio-ekonomike e fëmijës. Pra me përcaktimin e nevojave presupozohet se nevojat janë të njëjta për të gjithë. Gjë që nuk është e vërtetë, ngase nevojat e nxënësve dallojnë, njësoj se si dallojnë nevojat e shkollave të ndryshme. Një hap i rëndësishëm është bërë në këtë drejtim pasi me kurrikulën e re parashihet që shkolla të ketë më shumë autonomi për të vendosur në lidhje me temat e lëndëve të ndryshme dhe kohëzgjatjen e lëndëve në bazë të nevojave që kanë nxënësit e asaj shkolle. Por, nga zbatimi i kurrikulës rezultoi se mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollave nuk ishin të përgatitur për vendime të tilla, pasi ishin mësuar me qasjen e vjetër ku gjithçka u servohej e gatshme. Prandaj, duhet t'u bëhet një mbështetje më e madhe shkollave për përcaktimin dhe identifikimin e nevojave të nxënësve që do të çonte në një planifikim më të mirë të mësimdhënies dhe në rezultate më të mira të nxënësve.